

Harrim e ke emrin grua

Këto ditë, rastësisht, po shfletoja romanin “Gratë e Egalisë”, një libër satirik i autores norvegjeze Gerd Brantenberg. S’di pse mendja më shkoi te 8 marsi, te 8 marsi i grave shqiptare, në të vërtetë. Në këtë libër autorja, me një gjuhë të thukët deri në hidhësi, e kthen, në njëfarë mënyre, botën përmbys. Në Egalinë e shpikur prej saj, fuqinë, pushtetin, të drejtat, dominimin, e kanë gratë. Burrat, (hë, ata burrat e poshtër!) duhet të vuajnë, të mbajnë penismbajtës, sikurse gratë e pjesës tjetër të botës janë të detyruara të mbajnë përjetë gjimbajtëse, për t’u dalluar nga seksi tjetër. Gratë e këtij komuniteti egalian, kanë vetëm një obsesion: kur shohin burrat, mendja u shkon veç te seksi. Burrat për ta janë vetëm objekt seksi. Për të tjerat, ato janë vetë të zonjat. Pse jo? Burrat bëjnë fëmijët, ata bëjnë punët e shtëpisë, ata i kanë të gjitha përgjegjësitë, ata kanë vuajtjen. Kjo, Egalia, është vetëm fantazi, mos u trembni! Këtë vend virtual, me emrin Egali, kuptohet, çdo burrë do ta urrente me shpirt dhe do të tmerrohej po ta mendonte vetëm një çast.

Tani t’i kthehem titullit tim që duket i egër dhe i paturpshëm. A do ta pranoni aq lehtë burrat shqiptarë Egalinë? Përse, atëherë, gratë tona e pranojnë kaq lehtësisht të jenë pjesëtare të “BurroGalisë” shqiptare? Për 8 mars më erdhën ftesa të shumta nga shoqata e komunitete grash nëpër Shqipëri. Nuk e di a duhet të shkoja në to. Jam e lumtur vetëm (ç’ngushëllim!) që s’kam as tundimin më të vogël të marr pjesë në to ngaqë nuk jam aty. Jam larg, diku në Evropë dhe kthimin për në atdhe e shtyva një ditë edhe për këtë shkak. Nuk dua të jem dëshmitare e manifestimit të paditur të 8 marsit shqiptar. Shqetësohem kur shoh çfarë ndodh përreth, se si një ditë e tillë është një festë e madhe e pëshitirë.

E në fakt, çfarë ndodh me ne? Çfarë bëjmë ne, gratë shqiptare, sot? Ne u çojmë sms-ra pafund njëra-tjetrës duke glorifikuar deri në absurd një shëmti të radhës, si kjo kinse festë, ulemi në restorante, hamë, pimë dhe vallëzojmë me njëra-tjetrën, duke bërë më së shumti shaka pa kripë ndaj burrave (ndaj bashkëshortëve tanë dhe burrave në përgjithësi), pse jo, duke i nxjerrë (sigurisht, vetëm në shakatë tona) ata jashtë loje! Ne i blejmë dhurata njëra-tjetrës dhe presim të na blejnë dhurata. Të shumtat nga ne e dinë se të njëjtat dhurata (mbase ca më të shtrenjta se tonat), u janë bërë nga burrat tanë edhe të dashurave të tyre. Por ne, prapë jemi të lumtura. Ne jemi aq të kënaqura me njëra-tjetrën, aq të dehura, aq të ngazëllyera, saqë kur ndeshim njëra-tjetrën në rrugë e përgëzojmë dhe e urojmë. Ne jemi në delir të plotë. Sot është dita jonë. Sot, rrup-sup burrave. Dhe mua më bëhet sikur ne presim vetëm këtë ditë të njohim njëra-tjetrën, pse jo, t’i themi njëra-tjetrës kur takohemi në rrugë: “Njatjeta, vaginë! Edhe unë jam si ty! Sa mire që u njohëm dhe dalluam se jemi njësoj. Hajde, pra, të festojmë!” Çfarë sarkazme! Sot ne i nxorrëm burrat jashtë loje, pa e ditur se kemi një “lojë” të gjatë për të luajtur përditë me ta. Sepse ne e dimë shumë mirë se pa praninë e tyre, ne nuk dallohemi dot se jemi femra. Ne sot vetëm e harrojmë, për qejfin tonë.

Sot është një nga të 365 ditët e vitit. Ah, sa të mirë janë burrat sot me ne! Sot na kanë dhënë lirinë. Nuk na lënë të gatuajmë (madje gatuajnë vetë ata), na largojnë nga përgjegjësia e fëmijëve, na lënë të festojmë me njëra-tjetrën, të pushtojmë diskotekat, të kthehemi në shtëpi kur të duam, na blejnë dhurata, pra, na çlirojnë nga çdo detyrim tonin. Sot ne urdhërojmë dhe urdhrat tona janë ligje. Kështu, pa e kuptuar, ne kthehemi këtë ditë, me shumë gëzim madje, pjesë e një

karnavaleje të madhe sociale. Sikurse dita e karnavaleve, përdoret nga puëtorët si një mundësi për t'u çliruar nga detyrimet e rënda të punës së tyre të përditshme, edhe dita e karnavaleve tona grarore, na bën t'i harrojmë 364 ditët e tjera të robërimit tonë fizik, moral, shoqëror, kulturor, seksual, mendor... Dhe ne, gratë shqiptare, e kthejmë veten tonë në bufone të karnavales së madhe me emrin 8 Marsi. Sikurse në karnavale, o gra, ne vishemi ndryshe, vëmë maska dhe sillemi si idioete për të harruar fatkeqësisht a paditurisht, të përditshmen tonë vrasëse. Ne e kthejmë 8 Marsin në ditën e shakasë sonë të madhe.

E në të vërtetë, çfarë festojmë ne? A thua, sërish, 100 vjet më vonë me të njëjtin sllogan "Bukë e trëndafila" luftojmë për të drejtat tona? A thua, i hedhim në zjarr gjimbjatëset tona si protestë ndaj diskriminimit tonë gjinor? A thua, si të gjitha gratë e botës, ne po ngremë lart zërin, po themi se cilat jemi dhe sa të zonjat jemi? Unë nuk kam ndonjë përgjigje të plotë dhe definitive për këtë. Do të më duhej një roman i tërë mbase ta thoja siç duhej. Ne festojmë, më duket, viktimizimin tonë të përditshëm nga një shoqëri e tërë maskiliste, nga një shoqëri që na sheh si pronë të dikujt, dikujt me emër të përveçëm. Mbase festojmë abusimet seksuale të dhjetëra vajzave tona nëpër botë, shitjet dhe blerjet e tyre në kasaphanën e madhe të botës. Ne festojmë dhunën fizike dhe morale në familjet tona, vrasjet e adoleshenteve kur kthehen nga diskoteka se kanë prishur moralin e rrethinës ku jetojnë. Ne festojmë minorancën tonë në shoqërinë aktive e vendimarrëse, në parlament, partira, institucione. Për ne vendosin burrat, vetëm burrat. Ne festojmë zërin tonë të vakët për të drejtat tona. Ne festojmë ndërprerjen e shkollimit të vogëlusheve tona që duhet të punojnë që të ushqejnë familjen, martesat e tyre të detyrueshme në zonat rurale, MISS-ërimin e tyre në zonat urbane që të mund ta kenë më të lehtë ta çajnë jetën. Ne festojmë vuajtjen nga mungesa e kushteve për ta bërë jetën tonë më komode (pa ujë, pa drita, pa të ardhura të mjaftueshme) nga një shtet i drejtuar pothuajse nga burrat. Ne festojmë pagën më të vogël për të njëjtën punë si burrat. Ne festojmë detyrimin tonë për t'iu dhënë shefit që të mund të punojmë më gjatë. Ne festojmë kthimin tonë në kukulla për t'ia dukur përditë më të bukura burrave, të dashurve, miqve tanë. Ne festojmë, jo gëzimin tonë, por dhimbjen tonë. Shpërbërjen tonë. Harrimin tonë. Në fund të këtij aliteracioni të frikshëm më duhet të klith: Harrim, e ke emrin grua!

E në të vërtetë, për çfarë duhet të luftojmë? Besoj se duhet të luftojmë për liritë tona esenciale. Jo lirinë për të prishur *status quo*-në me burrat, por për të qenë partnere të denja të tyre. Jo për të qenë si ata, apo për t'i zëvendësuar ata (sikurse shumë lëvizje feministe mëtojnë), por për të patur të drejta të barabarta me ta. Ne gratë shqiptare, kam drojë, nuk kemi asnjë nerv proteste, sikurse edhe si komb kemi nerv të mpirë proteste. Ne, gratë shqiptare, në vend që të luftonim si simotrat tona anekënd botës, kemi gjetur një zgjidhje tjetër. I mundim burrat me joshje. Ne i bëjmë ata dashnorë. Dhe fundja, fatkeqësisht a fatmirësisht, mirë ua bëjmë! Ndoshta kjo mund të quhet njëfarë zgjidhjeje, e heshtur. Por, a ishte kjo më e drejta për veten, të gjenim këtë zgjidhje për t'i mbatur ekuilibret e brishta gjinore, dhe sa kredibilitet na jep kjo në sytë e tyre. Për vete, sot e gjithë ditën, dyshoj në respektin e burrave ndaj nesh, ndoshta edhe për këtë arsye që përmenda. Ne u dhamë atyre armë kundër vetes. Dhe një armë e tillë është edhe ky lloj 8 Marsi ku s'bëjmë gjë tjetër, veç i thërrasim njëra-tjetrës: Vagina shqiptare, bashkohuni!

Holandë, 8 Mars 2008